

# AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "VIDORA"

### KREU I

## EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

### NENI 1

Në Tiranë, sot me datën **08.07.2021** (dymijë e njëzetënjë) unë, **Vigan Ramiz Bujupi**, shtetas i Kosovës me lejeqendrimi të përhershme në Republikën e Shqipërisë, lindur më 05.05.1996 në Mitrovicë me banim në Tiranë me nr. Personal **1172065933**, madhor e me zotësi të plotë, me vullnet të lirë e të plotë dhe iniciativën e lirë private mbështetur :

- Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
- Në ligjin **Nr.9901**, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" e ndryshimet përkatëse deri në datën e sotme.
- Në ligjin **Nr. 9723**, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
- Në atë doganor, fiskal e tatimor, krijoj shoqërine me përgjegjësi të kufizuar, **Vidora Sh.p.k** në Tiranë.

### NENI 2

Shoqëria tregtare është vendase dhe emërtohet **VIDORA Sh.p.k**, emërtimi I së cilës do të jetë I stampuar dhe në vulën e saj.

### NENI 3

Selia qendrore e shoqërisë VIDORA Sh.p.k është në rrugën "**Abdi Toptani, Torre Drini, zyra 3, kati 0, Tiranë**"

### NENI 4

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit.



Me vendim të Ortakut mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë hapur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si degë apo përfaqësi jashtë vendit krijohen konform legjislacionit të shtetit të huaj, normave të së drejtës ndërkombëtare private dhe parimeve të reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

## **NENI 5**

Kapitali themeltar I shoqërisë është 1000 ALL (njëmijë lekë), formuar dhe nënshkruar nga ortaku I vetëm, Vigan Bujupi 1 kuotë me 100% vlerë të kapitalit themeltar.

Ortakët kanë pavaresi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjetër të fituar. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

## **NENI 6**

Kapitali nuk mund të jetë kurrë I përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë, bëhet para regjistrimit në QKB për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik.

## **NENI 7**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është 5 vite, duke filluar ky afat nga data e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Me vendim të ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim I dërgohet menjëherë për depozitim Gjykatës kompetente për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

## **NENI 8**

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë tregtare VIDORA Sh.p.k është :

Në fushën e zbatimit të rregullores europiane EC261/2004 dhe asaj turke SHY PASSENGER për të drejtat e pasagjerëve në rastet e vonesave, anulimeve dhe mohimit të imbarkimit në fluturime. Asistencë për sigurimin e kompensimit financiar nga kompanitë ajrore për pasagjerët e ndodhur në rastet e përmendura si më lart.



Në fushën e aktivitetit si agjensi për shitje të biletave në transportin ajror, detar dhe tokësor.

Në fushën e aktivitetit si agjensi për shitje të paketave individuale dhe të organizuara turistike.

## **NENI 9**

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar.

Ushtrimin e aktiviteti tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe pajisur me certifikatat përkatëse në organin e Tatim Taksave në Tirane.

## **NENI 10**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj e normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

## **KREU II**

### **KUSHTET EKONOMIKE**

## **NENI 11**

Shoqëria hap llogari bankare në lekë dhe çdo lloj valute, në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaku ose Administratori i caktuar prej tyre, depozitojnë faksimile të firmave të tyre origjinale në bankat ku është hapur llogaria.

## **NENI 12**

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.

Ortaku ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tyre përfshirë dhe fondet e kontributet në natyrë duke marre dakortësinë 100% të zotëruesve të kapitalit.

Transferime të pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vërtetuara me akt notarial dhe për një gjë të tillë ortakët duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tretë duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u bëhen me dije.

### **NENI 13**

Kapitali themelor I Shoqërise mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që marrin ortakët, I cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës.

Ortakët së bashku me vendim me shkrim kanë të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themelor t'ia tjetërsoje një apo disa personave fizikë jashtë ortakërise ose personave juridikë, vendas apo te huaj mbi bazën e aktit noterial,duke ia mundësuar atyre dhe të drejtën e të qenurit ortak në raport me pjesën e kuotave të kapitalit të tjetërsuar.

Cdo vendim I ortakëve për ndryshimin e kapitalit themeltar I dërgohet QKB që e ka njohur dhe ka regjistruar shoqërine si person juridik.

### **KREU III**

## **ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE, TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE**

### **NENI 14**

Ortaku është organi më I lartë drejtues dhe vendimor I shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" I njeh asamblesë së ortakëve.

Ortaku mund t'ia delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e autorizimit të firmosur e vulosur prej tij.

### **NENI 15**

Ortakët, së bashku, mund të zgjerojnë shoqërine duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si benda dhe jashtë vendit.

## NENI 16

Personi juridik I shoqërisë ka dhe këto të drejta e detyra kryesore :

Të marrë pjesë në drejtimin edhe administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë dhe cdo veprimtari tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

Të kërkojë dhe ti jepën të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe I të gjitha dokumentave të përpunuara nga shoqëria, ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit ekonomik të bilancit kontabël apo për cdo llogari të hapur si dhe asaj likujduese dhe asaj rrjedhëse.

Të marrë pjesë në rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë në cfarëdo forme apo sasi, sipas kontributit të dhënë prej tij.

Të kryejë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt ligjore të Shoqërisë.

Emëron dhe shkarkon në cdo kohë Administratorin e Shoqërisë, cakton ekonomistin kontabël , e ngarkon për përgatitjen dhe evidentimin e pasqyrave e bilancit vjetor ekonomiko-financiar të aktivitetit të shoqërisë kur shoqëria kalon në biznes të madh, të cilin ia paraqesin ortakeve mbi bazën e raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit të tij, ortakët kanë të drejtën e miratimit vendimor të këtij bilanci.

Nxjerrja e bilancit financiar vjetor mbi bazën e të dhënave të kontabilitetit , bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Administratori I emëruar prej ortakëve me vendim të tyre, ushtron këto të drejta :

Mundëson për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen së janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj sic mund të jenë :

Të lidhin kontrata të ndryshme që kanë për objekt marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizikë dhe me ata juridikë, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe në raste të blerjes së pasurive të paluajtshme, të bëjë dhe transkriptimin e pronësisë së saj në favorin e tyre për të dokumentuar një rrethanë të tillë dhe si shtesë të kapitalit në natyrë sipas vendimit me shkrim të ortakëve së bashku.



Të kryejë cdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private dhe shtetërore, bankat e cdo niveli etj. kur kjo shoqërohet me vendimin me shkrim të personit juridik, që kanë te bejnë me garancitë sipërmarrjet, marrjen e kredive, siguracioneve, transportit (Brenda dhe jashtë vendit), për zhdoganimin e mallrave të importuar apo të eksportuar, atë të plotësimit me korrektesë të dokumentacionit fiksial e tatimor etj, e shlyerjen në kohë të cdo detyrimi.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve për veprimet e kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë statut dhe për dëmin e shkaktuar me faj, sipas rastit. Ortakët mund të ngrenë dhe kërkojnë ndaj tij padi për shlyerjen e dëmit civil duke përfshirë dhe të drejtën për të bërë kallëzim për ndjekje penale në Prokurorinë e juridiksionit tokësor ku ka selinë shoqëria.

### **NENI 17**

Përfaqësimi i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët si Brenda dhe jashtë vendit si rregull i përgjithshëm i përket administratorit, i cili është Z. Vigan Bujupi

### **NENI 18**

Personi juridik dhe administratori i shoqërisë kanë të drejtë për nevojë të ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të punësojnë shtetas të ndryshëm, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke e lidhur kontratën sipas kritereve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi të miratuar me ligjin nr 7961 datë 12.07.1995 ndryshuar dhe në ligjin nr. 7703 date 11.05.1993 "për sigurimet shoqërore" si dhe përshtatje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës së caktuar nga vetë punëdhënësi.

## **KREU IV :**

### **SHPERNDARJA E SHOQERISE**

#### **NENI 19**

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar sipas ligjeve në fuqi.

#### **NENI 20**

Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Regjistrin Tregtar.



## **NENI 21**

Likujdatori është i detyruar të jetë i vëmendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektin ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik, vendas apo te huaj.

## **NENI 22**

Cdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt ceshtja mund të bartet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

## **NENI 23**

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, i referohet udhëzimeve plotësuese dhe të ligjshme, të dhëna nga personi juridik si dhe legjislacioni në fuqi.

## **NENI 24**

Ky Akt Themelimi dhe Statut u redaktua në 2 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen, personi juridik themelues i shoqërisë tregtare "VIDORA Sh.p.k", nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur firmën e tij origjinale, autentiteti i te cilës vërtetohet nga noteri.

**Themeluesi I VIDORA Sh.p.k**

*Vjosa Beyarri*

